



Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

VENDIM Nr. 12

Tiranë, më 12.05.2020

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të “Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në UT”; miratuar me Vendim nr. 5, datë 10.02.2020, Kreu IV, neni 6, pika 2.a, neni 7, pika 7.d, neni 22, pika 2, neni 23; të Urdhrit nr. 99 të MASR-së, datë 26.03.2020, “Disa ndryshime në Urdhrit nr. 8, datë 14.01.2020, “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”; të Urdhrit nr.108, datë 08.05.2020 “Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL publike për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19”, pika 2, e cila parashikon vijimësinë e përgatitjes së zgjedhjeve; të Vendimit të KIZ-it nr. 9, datë 10.05.2020, Vendimit nr.11, datë 10.05.2020, KIZ-i i UT-së në mbledhjen e tij të datës 12.05.2020

VENDOSI:

1. KIZ të vijojë përgatitjet për zgjedhjet në UT, me qëllim zhvillimin e tyre menjëherë pas përcaktimit të datave përkatëse nga ministri i MASR-së referuar Urdhrit nr.108, pika 2.
2. KIZ pasi bashkëpunoi me sekretariatë e fakulteteve dhe bëri vlerësimin e dokumentacionit shoqërues për kandidatët “Anëtar i Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve”, në bazë të Vendimit të KIZ-it nr. 9, datë 10.05.2020, nga procesi i verifikimeve vëren **që vetëm në listat e mbështetësve** nga këta kandidatë janë vërejtur “pasaktësi të dukshme”, referuar standardeve që përcakton rregullorja e zgjedhjeve Kreu IV, neni 22, pika 2. Ligjërimi i saktësisimit të pasaktësive është në zbatim të nenit 112 të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, sipas të cilit “organi publik në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme në një akt administrativ”, sikurse edhe efektet që krijon për veprimtarinë e KIZ-it, Urdhri nr.108, datë 08.05.2020 “Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL publike për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19”, pika 2.

3. **Përfshirja në këtë proces e studentëve aplikantë vlerësohet e pasaktë, jo përfundimtare si listë e konkurrentëve për “Anëtar për Senatit Akademik” në UT-ës.**
4. Kandidatëve studentë, pjesmarrës në Listën paraprake të shpallur nga KIZ me Vendimin nr. 9, datë 10.05.2020, KIZ **ju kërkon saktësimin rigoroz të dokumentave të aplikimit sipas standardit të listës zgjedhore sipas nenit. 22, pika. 2 dhe nenit 23 të Rregullores.** Listat të dërgohen në programin excel, **vetëm** në adresën kizut2016@gmail.com.
 - *Të shpallë të hapur procesin e aplikimit të kandidatëve të tjerë studentë që ende nuk janë përfshirë në këtë proces për “Anëtar i Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve” në Universitetin e Tiranës.*
5. Të shpallë të hapur procesin e regjistrimit të kandidatëve që nuk janë regjistruar për “Rektor” dhe “Anëtar i Senatit Akademik”, përfaqësues i personelit akademik” në Universitetin e Tiranës.
6. Regjistrimi i kandidatëve, që nuk kanë aplikuar **fillon menjëherë nga shpallja e këtij vendimi dhe do të vazhdojë deri në një datë të dytë, e cila do të shpallet nga KIZ në varësi të përcaktimit të datës së zgjedhjeve sipas urdhërit përkatës të MASR.**
7. Kërkesat e kandidatëve (pedagogë dhe studentë), bazuar në standardet e *Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në UT, vetëm* online në adresën kizut2016@gmail.com.
8. Regjistrimet e kryera të kandidatëve për “Rektor” dhe “Anëtar Senatit” dhe të shpallur nga KIZ i UT-ës dhe KZF-ve **janë të vlefshme.**
9. Ngarkohet Kryetari i KIZ-it dhe Kryetarët e KZF-ve për publikimin e këtij Vendimi sipas standardeve të përcaktuara në *Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në UT* dhe dërgimin e tij në adresat postare elektronike të UT-tës, të fakulteteve të UT-ës.
10. Ngarkohen Kryetarët e KZF-ve për vijimësinë e pranimit të regjistrimit të kandidatëve sipas kompetencave të përcaktuara në *Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në UT*, deri në një datë të dytë që do shpallet nga KIZ i UT-ës.
11. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të UT-së

1. Majlinda KETA
2. Bernard DOSTI
3. Oriona MUÇOLLARI
4. Ardian DOKA
5. Eglantina GISHTI
6. Eno LUSHKA